



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 248, Datë 03.09.2026

MBI

**MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË “RREGULLOREN PËR
PROCEDURAT DHE AFATET PËR DHËNIEN, MODIFIKIMIN, TRANSFERIMIN
OSE HEQJEN E LICENCAVE NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR”, MIRATUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 97, DATË 04.07.2017**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”; si dhe të neneve 18; 22, 23 dhe 24 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e Gazit natyror” i ndryshuar; neneve 15 dhe 26 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, si dhe nenit 19 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.97, datë 04.07.2017, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 03.09.2026, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1527/1 prot., datë 01.09.2026, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 04.07.2017, si dhe miratimin e Licencave Tip për operimin e impianteve të GNL-së/GNK-së me përmasa të vogla”

Konstatoi se:

- ERE me vendimin e bordit nr. 124, datë 06.05.2026, vendosi fillimin e procedurës për miratimin e disa ndryshimeve në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 04.07.2017.
- Në pikën 1 të dispozitivit të vendimit të bordit të ERE-s nr. 124, datë 06.05.2026, është referuar “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, ndërkohë që me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 04.07.2017, është miratuar “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin ose heqjen e licensave në sektorin e gazit natyror”, e cila është edhe rregullorja objekt i procedurës së filluar me vendimin nr. 124/2026. Për rrjedhojë, në vijim të procesit të miratimit të shtesave dhe ndryshimeve në këtë Rregullore, referimi në titullin e saj, për sa përcaktuar dhe në pikën 1, do të bëhet sipas emërimit të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 04.07.2017.
- Për efekt të vendimmarrjes së bordit, miratimi i Licencave Tip për operimin në impiantet e GNL-së dhe GNK-së me përmasa të vogla do të trajtohet veçmas nga miratimi i shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren e licencimit, duke qenë se këto licenca përbëjnë akte të posaçme rregullatore me përmbajtje dhe efekte të veçanta juridike. Për rrjedhojë, objekt i këtij vendimi është vetëm miratimi i shtesave dhe ndryshimeve në Rregullore, ndërsa Licencat Tip do të shqyrtohen dhe miratohen me vendimmarrje të veçantë të bordit të ERE-s.

- Ndryshimet e propozuara synojnë përditësimin e kuadrit rregullator të licencimit në përputhje me ndryshimet e ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, përfshirë parashikimin e veprimtarive të operimit të impianteve të GNL-së dhe GNK-së me përmasa të vogla.
- Fillimi i procedurës u vlerësua i nevojshëm për të reflektuar në kuadrin rregullator ndryshimet e parashikuara nga ligji nr. 81/2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 102/2015 ‘Për sektorin e gazit natyror’, të ndryshuar”, nëpërmjet të cilit janë parashikuar kategori të reja veprimtarish që i nënshtrohen licencimit nga ERE, përfshirë veprimtaritë e operimit të impianteve të GNL-së dhe GNK-së me përmasa të vogla.
- Ndryshimet e propozuara në Rregullore përfshijnë shtimin e kategorive të reja të veprimtarive të licencuara për operimin në impiantet e GNL-së dhe GNK-së me përmasa të vogla, përcaktimin e dokumentacionit teknik, mjedisor, financiar dhe administrativ që duhet të paraqitet për këto veprimtari, afatet dhe procedurën përkatëse të licencimit, si dhe përcaktimin e kohëzgjatjes së licencave përkatëse.
- Ndryshimet e tjera konsistojnë në plotësimin dhe saktësimin e përkufizimeve të përdorura në Rregullore, rishikimin e disa kërkesave të përgjithshme të dokumentacionit të aplikimit, përfshirë dokumentacionin mbi gjendjen gjyqësore dhe garancitë financiare e fiskale, plotësimin e dispozitave që rregullojnë dhënien e licencës me kusht, afatin dhe mënyrën e verifikimit të përmbushjes së kushteve të vendosura, rastet e refuzimit të licencës, si dhe plotësimin e të dhënave që përmban Regjistri i Licencimeve dhe mënyrës së përditësimit të tij.
- Gjithashtu, në Aneksin A të Rregullores propozohet përfshirja e pagesave të regjistrimit dhe procedimit të aplikimeve për kategoritë e reja të licencimit, të përcaktuara sipas modelit të pagesave të aplikueshëm aktualisht për veprimtaritë e tjera të licencueshme të parashikuara në Rregullore. Në tërësi, ndërhyrjet e propozuara synojnë jo vetëm reflektimin në Rregullore të veprimtarive të reja të licencueshme të parashikuara nga ligji nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, por edhe plotësimin dhe qartësimin e disa aspekteve procedurale të procesit të licencimit. Në kuadër të procedurës së konsultimit publik, drafti i ndryshimeve në rregullore u publikua në faqen zyrtare të ERE-s më datë 02.06.2026. Për efekt të korrigjimit të gabimeve materiale të konstatuara në tekstin e publikuar, versioni i korrigjuar i draft-aktit u publikua në faqen zyrtare të ERE-s më datë 03.07.2026.
- Me shkresën nr. 1680 prot., datë 25.05.2026, ERE njoftoi për fillimin e procedurës së miratuar me vendimin nr. 124, datë 06.05.2026, palët e interesit: Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE); Operatorin e Kombinuar të Gazit Natyror “ALBGAS” sh.a.; Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI); Ministrinë e Financave (MF); Autoritetin e Konkurrencës (AK); shoqërinë “Albpetrol” sh.a.; si dhe Operatorin e Pavarur të Sistemit të Transmetimit të gazit natyror (TAP AG), duke u dhënë mundësinë për të paraqitur opinionet dhe komentet e tyre mbi ndryshimet e propozuara në rregullore.
- ERE publikoi njoftim edhe në dy gazeta me qarkullim kombëtar, përkatësisht në gazetat “Tema” dhe “Panorama”, në datat 08.07.2026 dhe 09.07.2026.
- Në përfundim të konsultimit, rezultoi se shoqëria “SOCAR Gas Albania”, me e-mailin e datës 12.06.2026, paraqiti komente dhe sugjerime lidhur me projektaktet e publikuara për konsultim. Në lidhje me propozimet për ndryshimin e Rregullores objekt i kësaj procedure, komentet e shoqërisë lidhen me dy çështje: (i) përcaktimin e një pragu ose diapazoni sasior për termin “sasi të vogla”, të përdorur në përkufizimin e “Impiantit në shkallë të vogël”; dhe (ii) përdorimin e termit “shpërndarje”.
- Në lidhje me komentin për përcaktimin e një pragu ose diapazoni sasior për termin “sasi të vogla”, ERE vlerësoi se përkufizimi i “impiantit me përmasa të vogla” është përcaktuar në nenin 4, pika 17/1, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, i cili nuk përcakton një prag apo diapazon sasior konkret. Për rrjedhojë, u vlerësua të ruhet përkufizimi ligjor, pa përcaktuar në aktin rregullator një kufi sasior që nuk parashikohet në ligj.

- Në lidhje me komentimin për përdorimin e termit “shpërndarje” dhe sugjerimin për përdorimin e termave “dorëzim” ose “furnizim”, ERE vlerësoi se emërtimi dhe përcaktimi i veprimtarive të parashikuara në Rregullore duhet të jenë në përputhje me terminologjinë dhe konceptet e përcaktuara në ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar. Për këtë arsye, termi “shpërndarje” u vlerësua të ruhet, pasi është pjesë e përkufizimit të përcaktuar nga ligji, ndërsa “furnizimi” përbën një veprimtari të veçantë të licencueshme. Për rrjedhojë, as ky koment nuk reflektohet në ndryshimet e Rregullores sipas kësaj vendimmarrje .
- Nga shqyrtimi i komenteve të paraqitura nga shoqëria “SOCAR Gas Albania” që lidhen me Rregulloren objekt të kësaj procedure, rezulton se ato kanë natyrë kryesisht sqaruese lidhur me kuptimin e termave dhe kufijtë e veprimtarive të licencuara dhe nuk paraqesin kundërshtime ndaj qëllimit, përmbajtjes apo efekteve të ndryshimeve të propozuara në Rregullore.
- Ndryshimet e propozuara në Rregullore sigurojnë përditësimin e kuadrit rregullator të licencimit në përputhje me ndryshimet e ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, duke reflektuar kategoritë e veprimtarive të licencueshme të parashikuara nga ky ligj, dokumentacionin, afatet dhe procedurat përkatëse të licencimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në “*Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin ose heqjen e licensave në sektorin e gazit natyror*”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 04.07.2017. (sipas ndryshimeve të propozuara bashkëlidhur).
2. Drejtoria e Rregullimit të Gazit Natyror, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

Shtesat dhe ndryshimet në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licensave në sektorin e gazit natyror”, (miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 248 ,datë 03.09.2026)

Neni 1 bëhet: Kjo Rregullore hartohet në zbatim të neneve 22, 23 dhe 24 të ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Entit Rregullator të Energjisë”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, të ndryshuar.

Neni 2 bëhet: Kjo rregullore përcakton procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licensave për veprimtaritë e rregulluara në sektorin e gazit natyror, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, si dhe përcakton autoritetin e ERE-s për shqyrtimin e aplikimeve, dhënien e licensave me kusht dhe vendosjen e pagesave përkatëse për çdo aplikim.

Neni 3 shtohen përkufizimet si në vijim:

“Gaz Natyror i Lëngëzuar” (GNL) është gazi metan CH₄, i cili kthehet në lëng në presionin 1 atm dhe temperaturë minus 161 gradë celsius.

“Gaz Natyror i Komprimuar” (GNK) është gazi metan CH₄, i cili komprimohet në presionin 200 atm. ”.

“Impliant me përmasa të vogla” është njësia lëvizëse që përdoret për prodhimin/depozitimin, transportimin dhe/ose shpërndarjen e sasive të vogla të GNL-së dhe/ose GNK-së.

“Termat e përdorura në këtë rregullore, do kenë të njëjtin kuptim si ato të referuara në ligjin nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar.

Neni 4 pika 1 shtohen gërmat:

- ë. Operimin në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla;
- f. Operimin në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla.

Neni 5 bëhet: Kohëzgjatja e vlefshmërisë së një License të lëshuar sipas kësaj Rregulloreje për transmetim, shpërndarje, depozitim dhe GNL prej ERE në përputhje me nenin 4 të kësaj Rregulloreje, do të jetë për një periudhë prej 30 vitesh, me të drejtë përsëritjeje. Kohëzgjatja e vlefshmërisë të një Licence për furnizimin, tregtimin, funksionimin e operatorit të tregut të gazit natyror dhe operimin në impiantet e GNL-së dhe/ose GNK-së me përmasa të vogla është deri në 10 vjet, me të drejtë përsëritjeje.

Neni 8, pika 6, gërma “a”, ndryshon dhe bëhet : Një kopje origjinale ose fotokopje e njehsuar me origjinalin sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 9 ndryshon si vijon:

Pika 1 Gërma a) shtohen aktivitetet: *Operimin në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla; Operimin në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla dhe në tablë bëhen shënimet si vijon:*

Tipi i Impiantit	GNL sasive të vogla ☐	prodhim ☐
		depozitim ☐
		transport ☐
		shpërndarje rigazifikim ☐
	GNK sasive të vogla ☐	prodhim kompresim ☐
		depozitim ☐
		transport ☐
		shpërndarje ☐

Në nenin 9 pika 1 gërma d) pikat (ii) dhe (iii) ndryshojnë dhe bëhen:

(ii) Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve), që vërteton se personi juridik dhe administratorit/administratorëve të shoqërisë tregtare nuk janë të dënuar.

(iii) Në rastin e subjekteve me nënshtetësi të huaj, duhet të depozitohet vërtetimi i gjendjes gjyqësore të vendit të rezidencës, i përkthyer dhe i pajisur me vulë apostile.

Në nenin 9 pika 1 gërma e), Dokumentacioni dhe Garancitë Financiare dhe Fiskale; në pikën (iv) shtohet një paragraf :

Përrjashtohen nga ky detyrim edhe personat që aplikojnë për licensim në ushtrimin e aktivitetit të GNK-së (neni 4.1.ë) dhe rastit të aktivitetit të GNL-së (neni 4.1.f).

Në nenin 9 pika 2 pas gërmës f) shtohet; emërtesa g) në titullin: “Licence për operimin e tregut”

Në nenin 9 pika 2 pas gërmës g) shtohet; gërma gj);

gj. Licensë për operimin në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla

Aplikuesi për licensim për operim në impiantet e GNL duhet të depozitojë Informacion me të dhëna të përgjithshme dhe teknike të projektit që përfshijnë sa vijon:

i. miratimin nga organet përkatëse të menaxhimit dhe mbrojtjes së mjedisit (VNM, Deklaratë

- mjedisore, Leje) për ushtrimin e veprimtarisë sipas legjislacionit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis;*
- ii. projektin teknik të detajuar, të hartuar nga studio e licencuar, që përmban të dhëna për impiantin, vendndodhjen e instalimeve, hartat e vendndodhjes, skemat e tubave dhe Instrumenteve (P&ID), specifikimet teknike të pajisjeve kryesore (rezervuarë kriogjenikë për GNL), si dhe kapacitetet operacionale;*
 - iii. Marrëveshje paraprake për autorizimin e burimit të furnizimit me gaz nëpërmjet transaksioneve dypalëshe në baza afatshkurtra, por jo më pak se 1 (një) muaj;*
 - iv. vërtetimin nga ISHTI për Inspektim të të gjitha pajisjeve për efekt të sigurisë dhe pajtueshmërisë teknike;*
 - v. një dokument operacional që përmban manualin e operimit të impiantit, procedurat e mirëmbajtjes, sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe politikat e sigurisë industriale;*
 - vi. dokumentacion që vërtetën të drejtën e përdorimit të pajisjeve.*
 - vii. dëshmi për kualifikimin e stafit.*
 - viii. Çdo leje tjetër sipas legjislacionit në fuqi për transportin e mallrave të rrezikshme.*

Në nenin 9 pika 2 pas gërmës gj) shtohet; gërma h);

h. Licensë për operimin në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla

Aplikuesi për licencim për operim në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla duhet të depozitojë informacionin/dokumentacionin specifik si vijon:

- i. miratimin nga organet përkatëse të menaxhimit dhe mbrojtjes së mjedisit (VNM, Deklaratë mjedisore, Leje) për ushtrimin e veprimtarisë sipas legjislacionit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis;*
- ii. projektin teknik të detajuar, të hartuar nga studio e licencuar, që përmban të dhëna për impiantin, vendndodhjen e instalimeve, hartat e vendndodhjes, të dhëna për sistemet e kompresimit, skemën e stacioneve të mbushjes (nëse aplikohet).*
- iii. marrëveshje paraprake për autorizimin e burimit të furnizimit me gaz nëpërmjet transaksioneve dypalëshe në baza afatshkurtra, por jo më pak se 1 (një) muaj;*
- iv. dëshmi të objekteve të autorizuar të magazinimit dhe mjeteve të specializuara të transportit (kamionë ose anije);*
- v. vërtetimin nga ISHTI për Inspektimet të të gjitha pajisjeve për efekt të sigurisë dhe pajtueshmërisë teknike, (Në rast se, në momentin e aplikimit, ky dokument nuk mund të paraqitet për shkak se impianti është ende në fazën e ndërtimit ose instalimit, ERE vlerëson plotësimin e kësaj kërkesë në përputhje me parashikimet e kësaj Rregulloreje për dhënien e licencës me kusht.);*
- vi. një dokument operacional që përmban manualin e operimit të impiantit, procedurat e mirëmbajtjes, sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe politikat e sigurisë industriale;*
- vii. dokumentacion që vërtetën të drejtën e përdorimit të pronës dhe të pajisjeve të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë.*
- viii. dëshmi për kualifikimin e stafit.*

Në nenin 12 pas pikës 5 shtohen, pikat 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12:

6. ERE mund të japë një vendim licencimi me kusht kur gjykon se ndonjë nga kushtet e paplotësuara nuk është thelbësor për ushtrimin e menjëhershëm të veprimtarisë dhe aplikuesi merr përsipër ta plotësojë atë brenda një periudhe të caktuar.

7. Periudha e plotësimit të kushtit nuk mund të jetë më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e hyrjes në fuqi të licencës me kusht, sipas nenit 24, pika 2 të ligjit nr. 102/2015.

8. Vendimi i ERE-s për dhënien e licencës me kusht specifikon:

- a) kushtin e paplotësuar dhe arsyen pse konsiderohet jo thelbësor;
- b) afatin e saktë të plotësimit të kushtit;
- c) dokumentacionin ose provat që duhet të paraqesë i licencuari për verifikimin e plotësimit;
- d) pasojat ligjore nëse kushti nuk plotësohet brenda afatit.

9. I licencuari me kusht paraqet pranë ERE-s provat e plotësimit të kushtit jo më vonë se 30(tridhjetë) ditë para skadimit të afatit të përcaktuar.

10. Nëse kushti plotësohet brenda afatit, ERE merr vendim për heqjen e kushtit dhe lëshimin e licencës përkatëse pa kusht.

11. Nëse kushti nuk plotësohet brenda afatit të përcaktuar, ERE rishikon vendimin e licencimit me kusht dhe vendos në përputhje me kushtet dhe pasojat e përcaktuara në këtë vendim.

12. ERE refuzon dhënien e licencës në rastet e parashikuara në nenit 26 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar..

Në vendimin e ERE-s për refuzimin arsyetohen shkaqet sipas pikës 1 të këtij neni.

Në Nenin 17 pika 4, ndryshon dhe bëhet:

4. Regjistri i licencimeve mbahet nga struktura përgjegjëse për licencimet në ERE dhe përditësohet pas çdo vendimmarrjeje të Bordit që sjell ndryshim në të dhënat e regjistrit si dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Regjistri përmban të dhënat e mëposhtme:

- a. emrin e të licencuarit;
- b. NUIS-in dhe selinë;
- c. numrin dhe serinë e licencës;
- d. veprimtarinë e licencuar;
- e. zonën e shërbimit;
- f. numrin dhe datën e vendimit të Bordit të ERE-s për dhënien e licencës;
- g. datën e fillimit dhe datën e përfundimit të vlefshmërisë së licencës;
- h. statusin aktual të licencës;
- i. numrin dhe datën e vendimeve të Bordit të ERE-s për modifikimin, transferimin ose heqjen e licencës, sipas rastit;
- j. vendimet e licencimit të dhëna me kusht.

Në Aneksin A në tabelë shtohet sa vijon:

ANEKSI A
PAGESA E REGJISTRIMIT DHE PROCEDIMIT TË NJË APLIKIMI

AKTIVITETI	Licencim	Modifikim	Rinovim	Transferim licence/asetesh
Operimi në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla	1 000 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë
Operimi në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla	1 000 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë

Shënim:

a) Aplikuesi, në momentin e paraqitjes së aplikimit, duhet të ketë kryer pagesën sipas përcaktimeve të këtij Aneksi. Pagesa e aplikimit është e pakthyeshme dhe mund të kryhet drejtpërdrejt në llogarinë bankare pas lëshimit të një fature elektronike nga struktura e financës në ERE, sipas kërkesës së vetë aplikuesit:

Shërbimi i komisionit të bankës (në nisje dhe mbërritje) paguhet nga aplikuesi.

b) Aplikuesi, në momentin e paraqitjes së aplikimit, bashkëlidh Deklaratën si më poshtë:

DEKLAROJ SE:

- Nuk më është hequr apo refuzuar më parë një licencë për operimin në sektorin e gazit natyror brenda apo jashtë vendit.

(Nëse aplikuesit i është hequr apo refuzuar më parë një licencë, duhet të bëjë me dije arsyet dhe vendimin përkatës)

- Jam njohur me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi dhe angazhohem për zbatimin e tij, si dhe të rregullave dhe rregulloreve të miratuara nga ERE për operimin në sektorin e gazit natyror.
- Dokumentet dhe të dhënat e paraqitura për qëllime të këtij aplikimi janë të vërteta dhe jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve

të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

- Jam i gatshëm të marr pjesë në seanca dëgjimore ose mbledhje, kur kërkohet nga ERE, në kuadër të shqyrtimit të këtij aplikimi.
- Kam kryer pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të rregullores, në datën __.__.__, pranë Bankës _____.

Deklaroj veprimtaritë e tjera tregtare që ushtroj në Shqipëri ose jashtë saj, si dhe, sipas rastit, marrëdhënien e tyre me veprimtarinë objekt të këtij aplikimi për licencim. _____

Për aplikuesin

(emër mbiemër, nënshkrim)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Miratuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 97, Datë 04.07.2017, ndrshuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 248, Dattë 03.09.2026¹

**RREGULLORJA PËR PROCEDURAT DHE AFATET PËR DHËNIEN, MODIFIKIMIN,
TRANSFERIMIN OSE HEQJEN E LICENSAVE
NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR**

Përmbajtja:

KREU I.

DISPOZITA TË ËRGJITHSHME.....	2
Neni 1 - Autoriteti.....	2
Neni 2 - Qëllimi i Rregullores.....	2
Neni 3 - Përkufizime.....	2
Neni 4 -Aktivitetet e Liçensuara	4
Neni 5 - Kohëzgjatja e Vlefshmërisë së Liçensës.....	5

KREU II.

PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR LICENSË.....	5
Neni 6 - E Drejta për të Aplikuar për Liçensë.....	5
Neni 7 - Përfaqësuesi i Aplikantit.....	5
Neni 8 – Paraqitja e një Aplikimi për Liçense	6
Neni 9 -Format dhe Dokumentacioni për Aplikim	6
Neni 10 - Vlerësimi i Dokumentacionit të Aplikimit për Liçensë.....	13
Neni 11 - Vendimarrja e Bordit të ERE.....	14
Neni 12 - Dhënia ose Refuzimi i Liçensës.	15

KREU III –

NDRYSHIMI, DHE TRANSFERIMI I LICENSAVE.....	16
Neni 13 - Procedurat e Ndryshimit të Liçensave.....	16
Neni 15 - Transferimi i Pjesshëm ose i Plotë i Liçensës ose Aseteve të të Liçensuarit.	16

KREU IV

¹ *Me ngjyrë të kuqe janë reflektuar të gjitha shtesat dhe ndryshimet në zbatim të Vendimit të bordit të ERE-s, nr. 248/2026.*

SANKSIONET DHE HEQJA E LICENSËS.....	18
Neni 16 Sanksionet kundër të Liçensuarit.....	18
KREU V	
LËSHIMI DHE RREGJISTRIMI I LICENSAVE.....	19
Neni 17 - Regjistri i Liçensave.....	19
Neni 18 - Informimi i Publikut	19
KREU VI.	
DISPOZITA TË FUNDME	20
Neni 19 - Amendimi i Rregullores.....	20
Neni 20 - Hyrja në Fuqi	20

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Autoriteti

Kjo Rregullore hartohet në zbatim të neneve 22, 23 dhe 24 të ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Entit Rregullator të Energjisë”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, të ndryshuar.

Neni 2

Qëllimi i Rregullores

Kjo rregullore përcakton procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave për veprimtaritë e rregulluara në sektorin e gazit natyror, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, si dhe përcakton autoritetin e ERE-s për shqyrtimin e aplikimeve, dhënien e licencave me kusht dhe vendosjen e pagesave përkatëse për çdo aplikim.

Neni 3

Përkufizime

Përkufizimet e termave të përcaktuara në;

- (i) Ligjin "Për Sektorin e Gazit Natyror" Nr. 102/2015, "Për Sektorin e Gazit Natyror “
- (ii) Ligjin "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”
- (iii) Rregullat e Organizimit dhe funksionimit të ERE, janë të përfshira në këtë dokument për të gjitha qëllimet. Në këto rregulla termat e mëposhtëme do të kenë këto kuptime:

"Aplikues" do të thotë çdo Person i cili aplikon për një procedim nga procedurat sipas kësaj Rregulloreje.

"Aplikim" do të thotë depozitimi i dokumentave për një nga procedurat e parashikuara në këtë rregullore sikurse shpjeguar në nenet 8 dhe 9 të kësaj Rregulloreje.

“Bordi i ERE” ose **"Bordi"** do të thotë organi vendimmarrës i ERE që përbëhet nga pesë anëtarë të emëruar sipas procedurave të parashikuara nga Ligji Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe Ligji nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror.

"ERE" do të thotë Enti Rregullator i Energjisë që vepron në bazë të Ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

"Garanci e Performancës" do të thotë një angazhim nga shoqëria mëmë e Aplikantit ose të Licensuarit për të siguruar përmbushjen në mënyrë të ndershme dhe të besueshme prej këtij Aplikanti ose të Licensuari të të gjithë termave dhe kushteve të Licensës. Në rastet kur nuk ka shoqëri mëmë atëherë çdo pronar që zotëron 5% ose më shumë të aksioneve ose të kapitalit të tij në këtë Aplikim ose Licensë do të lëshojë një Garanci Performance të tillë.

"Garanci Financiare" do të thotë një garanci nga një bankë ose Persona të tjerë përgjegjës, të pranueshëm për ERE, për të mbuluar dhe siguruar përmbushjen në mënyrë të ndershme dhe të besueshme të detyrimeve financiare të Aplikantit ose të Licensuarit, sikurse mundet të jetë rasti, sipas termave dhe kushteve të Licensës.

"Gaz Natyror" është gaz metan, përfshirë gazin shoqërues, si dhe të gjitha hidrokarburet që janë në gjendje të gaztë, në kushte atmosferike normale, i cili, përfshin edhe GNL-në, biogazin ose lloje të tjera gazi, që transmetohen dhe shpërndahen në sistemin e tubacioneve.

"Licensë" do të thotë një e drejtë e dhënë nga ERE për ushtrimin e një veprimtarie në përputhje me Ligjin Nr 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror"

"I Licensuar" do të thotë Personi i pajisur me një Licensë dhënë nga ERE për të kryer aktivitete në sektorin e gazit natyror, në përputhje me dispozitat e ligjit 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror".

"OST" do të thotë Operator i Sistemit të Transmetimit të Gazit.

"OSSH" do të thotë Operator i Sistemit të Shpërndarjes së Gazit.

"Person" do të thotë çdo person juridik.

"Përfaqësues Zyrtar" do të thotë Personi i emëruar nga organet drejtuese të personit juridik të autorizuar sipas legjislacionit Shqipëtar në fuqi, për të përfaqësuar Aplikuesin ose të Licensuarin për të gjithë qëllimet sikurse përcaktuar në këtë Rregullore.

"Sistem" do të thotë çdo rrjet transmetimi, rrjet shpërndarjeje, impiant GNL ose hapësirë depozitimi, në pronësi ose përdorim/operim nga një i Licensuar, përfshirë "linepack" së bashku me instalimet dhe funksionet e tij që sigurojnë shërbime ndihmëse, si dhe ato që janë të nevojshme për mundësimin e hyrjes në rrjetet e transmetimit, shpërndarjes dhe impiantet e GNL. **"Rregullore"** do të thotë ky dokument i titulluar "Rregullat dhe kërkesat për dhënien modifikimin transferim dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror.

"Tarifë Aplikimi" është pagesa përkatëse, e vendosur nga Bordi i ERE në përputhje me nenin 14 të Ligjit Nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror", që çdo Person ose i Licensuar duhet kryejë ndaj ERE në përputhje me këtë Rregullore për trajtimin e kërkesës së paraqitur për Licensim, ndryshim, transferim License.

"Gaz Natyror i Lëngëzuar" (GNL) është gaz metan CH₄, i cili kthehet në lëng në presionin 1 atm dhe temperaturë minus 161 gradë celsius.

"Gaz Natyror i Komprimuar" (GNK) është gaz metan CH₄, i cili komprimohet në presionin 200 atm."

“Impiant me përmasa të vogla” është njësia lëvizëse që përdoret për prodhimin/depozitimin, transportimin dhe/ose shpërndarjen e sasive të vogla të GNL-së dhe/ose GNK-së.

“Termat e përdorura në këtë rregullore, do kenë të njëjtin kuptim si ato të referuara në ligjin nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar.

Neni 4

Aktivitetet e Licensuara

1. ERE mund të japë Licensa për veprimtaritë e përcaktuara nga Ligji Nr. 102/2015, "Për Sektorin e Gazit Natyror" sikurse vijojnë:

- a. Transmetim të gazit natyror;
- b. Shpërndarje të gazit natyror;
- c. Furnizim të gazit natyror (shitje me pakicë);
- ç. Tregtim të gazit natyror (shitje me shumicë)
- d. Operim të hapësirave të depozitimit të gazit natyror;
- dh. Operim në impiantet e GNL-së.
- e. funksionimin e operatorit të tregut të gazit natyror;

ë. Operimin në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla;

f. Operimin në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla.

2. Ushtrimi i çdo aktiviteti të sipërpërmendur kërkon Liçensë të veçantë.

3. Licensat do të lëshohen nga ERE në përputhje me këtë Rregullore rast pas rasti dhe do të jenë të mbështetura në Licensat model përkatëse të miratuara nga ERE.

Neni 5

Kohëzgjatja e Vlefshmërisë së Liçensës

Kohëzgjatja e vlefshmërisë së një License të lëshuar sipas kësaj Rregulloreje për transmetim, shpërndarje, depozitim dhe GNL prej ERE në përputhje me nenin 4 të kësaj Rregulloreje, do të jetë për një periudhë prej 30 vitesh, me të drejtë përsëritjeje. Kohëzgjatja e vlefshmërisë të një Licence për furnizimin, tregtimin, funksionimin e operatorit të tregut të gazit natyror dhe operimin në impiantet e GNL-së dhe/ose GNK-së me përmasa të vogla është deri në 10 vjet, me të drejtë përsëritjeje.

KREU II

PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR LICENSË

Neni 6

E Drejta për të Aplikuar për Liçensë

Ka të drejtë të aplikojë për një liçensë të lëshuar nga ERE çdo person që ka vendqëndrimin e tij në Shqipëri dhe me objekt të veprimtarisë aktivitetin e kërkuar për liçencim. Cdo person i huaj duhet të krijojë një shoqëri tregëtare sipas legjislacionit në fuqi me objekt veprimtarie aktivitetin e kërkuar për liçencim nga ERE për të gjithë periudhën e vlefshmërisë së liçensës.

Neni 7

Përfaqësuesi i Aplikantit

1. Përfaqësuesi Zyrtar do të përfaqësojë Aplikantin përpara ERE për çdo çështje që ka të bëjë me Aplikimin ose Licensën që mundet të lëshohet.
2. Përfaqësuesi Zyrtar do t'i paraqesë në ERE prokurën, vendimin e shoqërisë ose çdo dokument tjetër të nënshkruar ose miratuar nga Aplikanti për caktimin e Përfaqësuesit Zyrtar si të autorizuarin e vet.
3. Përfaqësuesi Zyrtar do t'i paraqesë ERE një vendim të shoqërisë ose çdo dokument tjetër të miratuar në mënyrë të rregullt nga Aplikanti që autorizon këtë përfaqësues të depozitojë sipas rastit kërkesën për Licensë, ose modifikim, apo transferimin e saj.
4. Përfaqësuesit Zyrtar duhet:
 - a. të paraqesë Aplikimin për Licensë së bashku me dokumentacionin e kërkuar sipas neneve 8, 9 dhe 10 të kësaj Rregulloreje.
 - b. të paraqesë të dhëna dhe informacion shtesë të kërkuar nga ERE gjatë procesit të shqyrtimit të Aplikimit për Licensë.
 - c. të përfaqësojë Aplikantin në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me Aplikimin.
 - d. të përfaqësojë të Licensuarin në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me çdo Licensë të lëshuar në vijim të një Aplikimi brenda kufijve të kompetencave të dhëna në autorizimin e depozituar në ERE.
5. Aplikanti ose i Licensuari kushdo qoftë mundet të ndërrojë Përfaqësuesin e tyre zyrtar duke paraqitur menjëherë një njoftim me shkrim pranë ERE për këtë ndryshim të shoqëruar me prokurën ose autorizimin e organeve vendimmarrëse të shoqërisë për këtë qëllim.

Neni 8

Paraqitja e një Aplikimi për Licensë

1. Aplikimi konsiston në formatin e Aplikimit dhe dokumentacionin e përcaktuar në nenin 9 të kësaj Rregulloreje të plotësuar në mënyrë të rregullt nga Aplikanti.
2. Aplikuesi do t'i paguajë ERE Tarifën e Aplikimit në fuqi në kohën kur Aplikimi paraqitet.
3. Dokumentacioni i paraqitur nga Aplikanti do të jetë origjinal dhe në gjuhën Shqipe dhe në se është kopjuar ose përkthyer prej origjinalit atëherë dokumentet e kopjuara ose të përkthyera duhet të jenë të noterizuara.
4. Çertifikatat dhe deklaratimet që mbështesin Aplikimin duhet të jenë lëshuar jo më herët se 1 muaj prej datës së paraqitjes së Aplikimit.
5. Aplikanti do të sigurojë që i gjithë dokumentacioni teknik i paraqitur së bashku me Aplikimin e tij është përgatitur dhe nënshkruar nga ekspertë profesionistë të licencuar në fushën përkatëse. ERE mundet të kërkojë që këta ekspertë ta vërtetojnë ekspertizën e tyre.
6. Çdo Aplikim i shoqëruar nga dokumentacioni përkatës do të paraqitet në dy kopje;
 - a. **Një kopje origjinale ose fotokopje e njehsuar me origjinalin sipas legjislacionit në fuqi.**
 - b. Një fotokopje e printuar dhe një në format elektronik e të gjithë dokumentacionit sikurse përcaktuar në këtë Rregullore.

Neni 9

Format dhe Dokumentacioni për Aplikim

1. Forma e Aplikimit (për tu plotësuar nga Aplikanti)

Një Aplikim për një License do të përbehet nga:

a. Tipi i Aplikimit

1	Lloji i aplikimit	☐ Licensim	☐ Transferim	☐ Ndryshim	
2	Tipi i licensës	☐ Transmetim i gazit natyror ☐ Shpërndarje e gazit natyror ☐ Furnizim i gazit natyror (shitje me pakicë) ☐ Tregtim të gazit natyror; (shitje me shumicë) ☐ Operim i hapësirave të depozitimit të gazit natyror ☐ Operim i impianteve të GNL-së ☐ GNL sasive të vogla			Prodhim ☐ Depozitim ☐ Transport ☐ Shpërndarje rigazifikim ☐
		☐ GNK sasive të vogla			Prodhim kompresim ☐ Depozitim ☐ Transport ☐ Shpërndarje ☐

(Shënim: Vendosni X në kutinë përkatëse)

b. Informacion i përgjithshëm për Aplikantin (për tu plotësuar nga Aplikanti)

1	Emri i Aplikantit		
	Numri i regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit te Biznesit		
2	Zyra Qendrore e Shoqërisë	Adresa	
		Celular	
		Tel / Fax	
		Email	

3	Përfaqësuesi Zyrtar	Emri	
		Pozicioni	
		Adresa	
		Cel	
		Tel/ Fax	
		Email	

c. Të Dhëna mbi Aplikantin (për tu plotësuar nga Aplikanti)

1	<u>Unë, Aplikanti deklaroj se:</u> (a).Aplikantit nuk i është hequr asnjëherë ndonjë licencë e akorduar për gazin natyror ose (b).Aplikantit nuk i është refuzuar asnjëherë ndonjë Aplikim për licencë për gazin natyror. <u>në Shqipëri ose vende te tjera</u> <u>Në se përgjigja e ndonjërës prej pyetjeve (1.a) ose (1.b) është</u> <u>JO atëherë Aplikanti duhet të bashkëngjisë një shpjegim të plotë.</u>	Po ☐ Jo ☐ Po ☐ JO ☐
2	Unë, Përfaqësuesi Zyrtar, deklaroj në emër të Aplikantit se Aplikanti është në dijeni të kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi në sektorin e gazit natyror dhe paraqes angazhimin e Aplikantit për zbatimin korrekt të tyre.	Po ☐ Jo ☐
3	A është Aplikanti i angazhuar në ndonjë aktivitet tjetër tregtar në Shqipëri ose vend tjetër ? <u>Në se përgjigja e pyetjes 3 është PO atëherë Aplikanti duhet të bashkëngjisë shpjegime shtesë.</u>	Po ☐ Jo ☐

d. Dokumentacioni Ligjor, Administrativ dhe Pronësor

i) Akti i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Biznesit dhe statuti e akti i themelimit shoqërisë tregtare.

(ii) Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penalteti nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve), që vërteton se personi juridik dhe administratorit/administratorëve të shoqërisë tregtare nuk janë të dënuar.

(iii) Në rastin e subjekteve me nënshtetësi të huaj, duhet të depozitohet vërtetimi i gjendjes gjyqësore të vendit të rezidencës, i përkthyer dhe i pajisur me vulë apostile.

iv) Struktura organizative dhe funksionimi administrativ i shoqërisë. Lista e Personelit sipas profilit (në përputhje me aktivitetin për të cilin është kërkuar Licensa).

v) Me përjashtim të aplikimit për licensë të furnizimit (neni 4.1.c) dhe tregtimit (neni 4.1.ç), dhe operimit të tregut marrëveshja dhe leja e miratuar nga Këshilli i Ministrave. Identiteti i të gjithë Personave që kanë interes pronësor tek Aplikanti më të madh dhe të barabartë me 5%.

vi) Dokumentacioni që tregon titujt ose pronësinë mbi asetet që ka, që ka dedikuar ose ka nënkontraktuar/marrë me qera ose që pritet në mënyrë bindëse të përfitohen nga ose për Aplikantin për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën Licensën e kërkuar. Lejet dhe autorizimet mjedisor sipas rastit për aktivitetet ushtrimi i të cilave kyhet me asetet përkatëse.

e. Dokumentacioni dhe Garancitë Financiare dhe Fiskale;

i) Deklarime të lëshuara prej autoriteteve përkatëse për shlyerjen e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore, në masën që këto detyrime janë plotësuar prej Aplikantit.

- ii) Bilancet financiare të audituara nga një shoqëri audituese e akredituar, për secilin prej tre viteve të fundit që paraprijnë paraqitjen e Aplikimit.
- iii) Garancinë e përshtatshme Financiare [e pa aplikueshme për rastin e furnizimit (neni 4.1.c) dhe tregtimit (neni 4.1.ç)] dhe Garancinë e Performancës që sigurojnë aftësinë e Aplikantit për të përmbushur të gjithë detyrimet e tij nën Licensën e kërkuar, duke përfshirë, por pa u kufizuar; largimin përfundimtar të plotë ose të pjesshëm të pajisjeve dhe/ose infrastrukturës dhe rehabilitimin e mjedisit, si dhe mbështetjen menaxheriale, operacionale dhe financiare prej pronarëve të Aplikantit.
- iv) Me përjashtim të rastit të furnizimit (neni 4.1.c) dhe rastit të tregtimit (neni 4.1.ç) një çertifikatë sigurimi nga shoqëri sigurimi (që operojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri) që evidenton mbulimin e përgjegjësisë për dëmtimet për plagosje, sëmundje ose raste të vdekjes së Personave ose për humbjen ose shkatërrimin e pronës të shkaktuara ose që kanë rezultuar prej aktiviteteve të Aplikantit në kuadër të Licensës së kërkuar në një nivel përgjegjësie jo më të vogël se 10 milion USD. Kjo politikë ose këto politika sigurie do të jenë dhe qëndrojnë në fuqi dhe me efekt të plotë për të gjithë kohëzgjatjen e Licensës së kërkuar. Për më tepër i Licensuari do të mbetet përgjegjës për çdo dëmtim që do të mund të ndodhë prej, ose të lidhet me, ose të rezultojë prej aktiviteteve të kryera gjatë kohëzgjatjes së Licensës. **Përjashtohen nga ky detyrim edhe personat që aplikojnë për licensim në ushtrimin e aktivitetit të GNK-së (neni 4.1.ë) dhe rastit të aktivitetit të GNL-së (neni 4.1.f).**
- v) Vërtetimin e kryerjes së pagesës ndaj ERE-s të Tarifës së Aplikimit në fuqi në momentin e paraqitjes së Aplikimit
- vi) Një plan biznesi i cili përfshin një analizë të kostove dhe përfitimeve përfshirë kostot për largimin përfundimtar të pajisjeve dhe rehabilitimin e mjedisit me përfundimin e operacioneve.
- vii) Në se Aplikanti ka synim të përdorë një shoqëri menaxhimi për operacionet e tija ditore ai duhet të informojë ERE për këtë synim dhe të japë një Garanci të Performancës për kryerjen me ndershmëri dhe besueshmëri të veprimeve prej kësaj shoqërie menaxhimi.

2. Dokumente Specifike për Llojin e Licensës.

Në varësi të tipit të Licensës, Aplikanti do të paraqesë në ERE dokumentet që vijojnë ;

a.Licensa për Transmetimin e Gazit Natyror;

a.1 Subjekti që aplikon për një licencë në transmetimin e gazit natyror, duhet që më parë të çertifikohet sipas procedurës së përcaktuar në nenin 37 të ligjit 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”

a.2 Informacion me të dhëna të përgjithshme dhe teknike të projektit që përfshijnë sa vijon:

- i. Vendndodhjen e instalimeve dhe gjurmën e tubacioneve përfshirë hartën Topografike për territorin ku do të ushtrojë aktivitetin.
- ii. Kapacitetin maksimal teknik të kontraktuar dhe të disponueshëm në të gjitha pikat e hyrjes (in take) në Sistem dhe të daljes (off take) prej Sistemit dhe ndërlihdhet e tij me rrjete të tjera të Transmetimit dhe Shpërndarjes, impiantet e magazinimit, prodhimit dhe terminalët e GNL.
- iii. Volumet e projektuara ditore për tu përpunuar sipas vlerësimeve të Aplikantit.
- iv. Standardet teknike, presionet maksimale të projektuara, kërkesat e komprimimit dhe karakteristikat e tjera teknike të makinerive dhe pajisjeve teknike që do të instalohen.
- v. Presionet e punës të projektuara mbështetur në vlerësimet e Aplikantit.
- vi. Kategoritë dhe lista e konsumatorëve si dhe livrimet e parashikuara
- vii. Vendndodhjet e matësve dhe specifikimet.
- viii. Vendndodhjet e kontrollit të cilësisë së gazit.
- ix. Dëshmi të kontratave/angazhimeve për transportin e gazit.

- x. Kërkesat e pritshme për hyrje prej palëve të treta ose çdo kërkesë e pritshme për përjashtim nga e drejta për hyrje e palëve të treta, sikurse çdo vendim i dhënë më parë për përjashtim prej detyrimit të dhënies së të drejtës së hyrjes për infrastrukturën e reja sipas ligjit Nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror",
- xi. Lidhjet ndër-kufitare dhe parametrat e operimit në vendet fqinje.
- xii. Marrëveshjet operationale të balancimit.
- xiii. Burimi i synuar dhe procedura e prokurimit të gazit natyror të nevojshëm për balancimin e Sistemit të Transmetimit.
- xiv. Aftësia për lëvizjen në kah të kundërt.
- xv. Punët e Aplikantit për (a) zgjidhjen teknike të propozuar (b) vlerësimin e ndikimit mjedisor (c) vlerësimin e kostos (d) parashikimet ekonomike duke përfshirë mënyrat e financimit të cilat justifikojnë planin e biznesit për projektin e Transmetimit të gazit natyror të përgatitura nga një shoqëri e specializuar inxhinjerike .
- xvi. Programin e punës për zbatimin e projektit dhe jeta e pritshme e projektit.
- xvii. Planet vjetore të investimit për përmirësimin, zgjerimin ose modifikime të tjera të Sistemit të Transmetimit për një periudhë jo më pak se 5 vjet prej datës efektive të Licensës në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- xviii. Programi i parashikuar i mirëmbajtjes së Sistemit të Transmetimit.

b. Licensa për Shpërndarjen e Gazit Natyror:

Informacion me të dhëna të përgjithshme dhe teknike të projektit që përfshijnë sa vijon:

- i. Vendndodhjen e instalimeve dhe gjurmën e tubacioneve përfshirë hartën Topografike .
- ii. Zonën gjeografike të mbuluar nga Aplikimi.
- iii. Kapacitetin maksimal teknik të kontraktuar dhe të disponueshëm në të gjitha pikat e hyrjes (in take) në Sistem dhe të daljes (off take) prej Sistemit dhe ndërlidhjet e tij me rrjetet e tjera të Transmetimit dhe Shpërndarjes, impiantet e magazinimit, prodhimit dhe terminalët e GNL
- iv. Volumet e projektuara ditore për t'u përpunuar sipas vlerësimeve të Aplikantit.
- v. Standardet teknike, presionet maksimale të projektuara, kërkesat e komprimimit dhe karakteristikat e tjera teknike të makinerive dhe pajisjeve teknike që do të instalohen.
- vi. Presionet e punës të projektuara mbështetur në vlerësimet e Aplikantit
- vii. Kategoritë e konsumatoreve dhe livrimet e projektuara.
- viii. Vendndodhjet e matësve dhe specifikimet.
- ix. Planet e aromatizimit përfshirë vendndodhjet
- x. Dëshmi të kontratave/angazhimeve.
- xi. Kërkesat e pritshme për hyrje prej palëve të treta ose çdo kërkesë e pritshme për përjashtim nga e drejta për hyrjen e palëve të treta sikurse çdo vendim i dhënë më parë për përjashtim prej detyrimit të dhënies së të drejtës së hyrjes për infrastrukturën e reja sipas ligjit Nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror"
- xii. Lidhjet ndër-rajonale dhe parametrat e operimit të OSSH fqinje në se është e përshtatshme.
- xiii. Aftësia për lëvizjen në kah të kundërt në se është e përshtatshme.
- xiv. Punët e Aplikantit për (a) zgjidhjen teknike të propozuar (b) vlerësimin e ndikimit mjedisor (c) vlerësimin e kostos (d) parashikimet ekonomike duke përfshirë mënyrat e financimit të

cilat justifikojnë planin e biznesit për projektin e Shpërndarjes të gazit natyror të përgatitura nga një firmë e specializuar inxhinjerike.

- xv. Programin e punës për zbatimin e projektit dhe jeta e pritshme e projektit.
- xvi. Planet vjetore të investimit për përmirësimin, zgjerimin ose modifikime të tjera të Sistemit të Shpërndarjes për një periudhë jo më pak se 5 vjet prej datës efektive të Licensës në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- xvii. Programi i parashikuar i mirëmbajtjes së Sistemit të Shpërndarjes.
- xviii. Sasia mesatare e gazit natyror që parashikohet për t'u shpërndarë gjatë një viti mbështetur në një program tipik mujor.

c. Licensa për Operimin e Impianteve të Gazit Natyror të Lëngëzuar (GNL):

Informacion me të dhëna të përgjithshme dhe teknike të projektit që përfshijnë sa vijon:

- i. Tipi i impiantit të rigazifikimit
- ii. Hartat dhe vizatimet që tregojnë vendndodhjen e instalimeve në tokë dhe në det dhe pikën(at) e lidhjes me tubacionet tokësore të transmetimit përfshirë hapësirat e magazinimit që lidhen me operacionet e GNL.
- iii. Kapacitetin maksimal teknik, të kontraktuar dhe të disponueshëm në pikën e marrjes (off take) prej/për në terminal.
- iv. Volumet e projektuara ditore për t'u përpunuar sipas vlerësimeve të Aplikantit.
- v. Standardet teknike, presionet maksimale të projektuara, kërkesat e komprimimit dhe matjes dhe karakteristikat e tjera teknike të makinerive dhe pajisjeve teknike që do të instalohen.
- vi. Presionet e punës të projektuara mbështetur në vlerësimet e Aplikantit.
- vii. Programet e synuara të furnizimit dhe madhësia e anijeve çisternë të GNL.
- viii. Madhësia e rezervuarëve të depozitimit.
- ix. Burimet e furnizimit.
- x. Kategoritë dhe lista e konsumatoreve të pritshëm si dhe livrimet e projektuara.
- xi. Kërkesat e pritshme për hyrje prej palëve të treta ose çdo kërkesë e pritshme për përjashtim nga e drejta për hyrje e palëve të treta sikurse çdo vendim i dhënë më parë për përjashtim prej detyrimit të dhënies së të drejtës së hyrjes për infrastrukturën e reja sipas ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.
- xii. Punët e Aplikantit për (a) zgjidhjen teknike të propozuar (b) vlerësimin e ndikimit mjedisor (c) vlerësimin e kostos (d) parashikimet ekonomike duke përfshirë mënyrat financimit të cilat justifikojnë planin e biznesit për projektin e GNL të përgatitura nga një shoqëri e specializuar dhe e licensuar për këto shërbime.
- xiii. Programin e punës për zbatimin e projektit dhe jetëgjatësia e pritshme e projektit.
- xiv. Planet vjetore të investimit për përmirësimin, zgjerimin ose modifikime të tjera të impiantit të GNL për një periudhë jo më pak se 5 vjet prej datës efektive të Licensës në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- xv. Programi i parashikuar i mirëmbajtjes së impiantit të GNL.

d. Licensa për Operimin e Hapësirave të Depozitimit të Gazit Natyror:

Informacion me të dhëna të përgjithshme dhe teknike të projektit që përfshijnë sa

vijon:

- i. Vendndodhjen gjeografike të hapësirës së depozitimit nëntokësor dhe gjurmën e tubacioneve përfshirë një hartë topografike.
- ii. Përshkrim të kushteve gjeologjike të hapësirës depozituese nëntokësore.
- iii. Volumi maksimal i depozitueshëm dhe gazi i vet i nevojshëm.
- iv. Kërkesat minimale të cilësisë që duhet të plotësojë gazi që do të magazinohet.
- v. Profili i debiteve të ri-lëvrimit të gazit natyror.
- vi. Presioni maksimal i rezervuarit nëntokësor.
- vii. Numri i puseve dhe debitet maksimale të tyre të injektimit dhe të prodhimit.
- viii. Standardet teknike, presionet maksimale të projektuara, kërkesat e komprimimit dhe matjes dhe karakteristikat e tjera teknike të makinerive dhe pajisjeve teknike që do të instalohen.
- ix. Kërkesat minimale të cilësisë së gazit që do të livrohet sërish dhe instalimet që sigurojnë që cilësia e përcaktuar është arritur.
- x. Dëshmi të kontratave/angazhimeve për depozitim.
- xi. Kategoritë dhe listën e konsumatoreve(Projekti).
- xii. Kërkesat e pritshme për hyrje prej palëve të treta ose çdo kërkesë e pritshme për përjashtim nga e drejta për hyrje e palëve të treta sikurse çdo vendim i dhënë më parë për përjashtim prej detyrimit të dhënies së të drejtës së hyrjes për infrastrukturën e reja sipas Ligjit Nr. 102/ 2015, "Për Sektorin e Gazit Natyror"
- xiii. Punët e Aplikantit për (a) zgjidhjen teknike të propozuar (b) vlerësimin e ndikimit mjedisor (c) vlerësimin e kostos (d) parashikimet ekonomike duke përfshirë mënyrat e financimit të cilat justifikojnë planin e biznesit për projektin e depozitimit nëntokësor të gazit natyror të përgatitura nga një shoqëri e specializuar.
- xiv. Programin e punës për zbatimin e projektit dhe jetëgjatësia e pritshme e projektit.
- xv. Planet vjetore të investimit për përmirësimin, zgjerimin ose modifikime të tjera të hapësirave të depozitimit do të hartohen sipas nenit 56 pika 2 të ligjit 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror".
- xvi. Programi i parashikuar i mirëmbajtjes së hapësirave të depozitimit.

e. Licenca për Tregtim të Gazit Natyror :

Duhet të përmbajë Informacion të përgjithshëm që përfshin savijon:

- i. Sasinë mesatare të gazit natyror të shprehur në Milion Nm³, e parashikuar për t'u livruar gjatë një viti.
- ii. Garancinë që cilësia e gazit përmbush kriteret minimale të operatorit të Sistemit.
- iii. Kapitalin financiar të nevojshëm për kryerjen e aktivitetit që kërkohet prej Licensës dhe në veçanti për të mbuluar ekspozimin financiar të shkaktuar prej balancimit të gazit.
- iv. f. Licensë për Furnizim me Gaz Natyror

Duhet të përmbajë nformacion të përgjithshëm që përfshin sa vijon:

- i. Sasinë mesatare të gazit natyror të shprehur në milion N^{m3}, e parashikuar për tu livruar gjatë një viti.

- ii. Garancinë që cilësia e furnizimit me gaz përmbush kriteret minimale të operatorit të Sistemit.
- iii. Kapitalin financiar të nevojshëm për kryerjen e aktivitetit që kërkohet prej Licensës dhe në veçanti për të mbuluar ekspozimin financiar të shkaktuar prej balancimit të gazit.

g. Licensë për operimin e tregut

- a. Lista e të punësuarve, profesioni, formimi
- b. Dëshmi për posedimin e harduerit dhe softuerit të nevojshëm për komunikimin me të gjitha pikat e matjes si dhe me të gjithë pjesëmarrësit në treg(klientët e tyre)
- c. Lista e anëtareve të Këshillit Mbikqyrës.

gj. Licencë për operimin në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla

Aplikuesi për licencim për operim në impiantet e GNL duhet të depozitojë Informacion me të dhëna të përgjithshme dhe teknike të projektit që përfshijnë sa vijon:

- i. miratimin nga organet përkatëse të menaxhimit dhe mbrojtjes së mjedisit (VNM, Deklaratë mjedisore, Leje) për ushtrimin e veprimtarisë sipas legjislacionit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis;
- ii. projektin teknik të detajuar, të hartuar nga studio e licencuar, që përmban të dhëna për impiantin, vendndodhjen e instalimeve, hartat e vendndodhjes, skemat e tubave dhe Instrumenteve (P&ID), specifikimet teknike të pajisjeve kryesore (rezervuarë kriogjenikë për GNL), si dhe kapacitetet operacionale;
- iii. Marrëveshje paraprake për autorizimin e burimit të furnizimit me gaz nëpërmjet transaksioneve dypalëshe në baza afatshkurtra, por jo më pak se 1 (një) muaj;
- iv. vërtetimin nga ISHTI për Inspektim të të gjitha pajisjeve për efekt të sigurisë dhe pajtueshmërisë teknike;
- v. një dokument operacional që përmban manualin e operimit të impiantit, procedurat e mirëmbajtjes, sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe politikat e sigurisë industriale;
- vi. dokumentacion që vërteton të drejtën e përdorimit të pajisjeve.
- vii. dëshmi për kualifikimin e stafit.
- viii. Çdo leje tjetër sipas legjislacionit në fuqi për transportin e mallrave të rrezikshme.

h. Licencë për operimin në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla

Aplikuesi për licencim për operim në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla duhet të depozitojë informacionin/dokumentacionin specifik si vijon:

- i. miratimin nga organet përkatëse të menaxhimit dhe mbrojtjes së mjedisit (VNM, Deklaratë mjedisore, Leje) për ushtrimin e veprimtarisë sipas legjislacionit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis;
- ii. projektin teknik të detajuar, të hartuar nga studio e licencuar, që përmban të dhëna për impiantin, vendndodhjen e instalimeve, hartat e vendndodhjes, të dhëna për sistemet e kompresimit, skemën e stacioneve të mbushjes (nëse aplikohet).
- iii. autorizimin e burimit të furnizimit me gaz nëpërmjet transaksioneve dypalëshe në baza afatshkurtra, por jo më pak se 1 (një) muaj;
- iv. dëshmi të objekteve të autorizuar të magazinimit dhe mjeteve të specializuara të transportit (kamionë ose anije);
- v. vërtetimin nga ISHTI për Inspektim të të gjitha pajisjeve për efekt të sigurisë dhe pajtueshmërisë teknike;
- vi. një dokument operacional që përmban manualin e operimit të impiantit, procedurat e mirëmbajtjes, sistemin e menaxhimit të sigurisë dhe politikat e sigurisë industriale;
- vii. dokumentacion që vërteton të drejtën e përdorimit të pronës.
- viii. dëshmi për kualifikimin e stafit.

Neni 10

Vlerësimi i Dokumentacionit të Aplikimit për Licensë

1. Pasi shqyrton aplikimin e paraqitur, lidhur me plotësimin e kërkesave të nenit 8 dhe 9 Personat e Ngarkuar nga Drejtoria Përgjegjëse përgatit një relacion ku i propozon Bordit të ERE fillimin ose jo të procedurave për shqyrtimin e aplikimit në përputhje me afatet e përcaktuara në Rregullat për Organizimin, funksionimin dhe Procedurat e ERE-s dhe në këtë rregullore.
2. Çdo aplikim do të paraqitet në përputhje me formën, përmbajtjen, afatet dhe përcaktimet e kësaj rregullore duke plotësuar kërkesat dhe dokumentat e kërkuara në të. Në të kundërt Bordit të ERE-s, i propozohet mosfillimi i procedurave të shqyrtimit të aplikimit.
3. Bordi i ERE-s mund të vendos për fillimin ose jo të procedurave për shqyrtimin e aplikimit bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në relacionin e sipërpërmendur.
4. ERE mund të fillojë procedurat për shqyrtimin e një aplikimi edhe në rastet e përshkruara në pikën 4 të nenit 8 të kësaj rregullore, por vendimi përfundimtar për refuzimin ose licensimin do të merret vetëm pasi të jenë paraqitur lejet përkatëse nga institucionet e tjera.
5. Në rast refuzimi ERE do të njoftojë aplikuesin lidhur me arsyet e refuzimit dhe duke i dhënë udhëzimet e nevojshme brenda 7 ditë pune nga marrja e vendimit.
6. Aplikuesi mund të parqesë një aplikim të ri sipas kërkesave të kësaj rregullore dhe duke marrë në konsideratë udhëzimet e ERE-s.
7. Nëse aplikuesi paraqet aplikimin e ri në përputhje me pikën 6 të këtij neni brenda 1 muaji nga marrja e vendimi për mosfillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa e kryer për këtë procedurë do të konsiderohet i vlefshëm për aplikimin e ri.
8. Në rast të miratimit të fillimit të procedurave për shqyrtimin e aplikimit, brenda 2 ditëve pune nga marrja e vendimit ERE publikon në median e shkruar për dy ditë me radhe një njoftimin për aplikimin e paraqitur në tre gazeta të përditshme me shpërndarje në të gjithë vendin që botohen në Tiranë.
9. Njoftimi përmban një informacion të shkurtër për aplikimin e paraqitur; një njoftim që paraqitja e objeksioneve ose ankesave nga personat e interesuar mund të bëhen në ERE brenda afateve të përcaktuara nga kjo rregullore.
10. Pas publikimit në media të njoftimit, ERE do të sigurojë që për një periudhë 30 ditë pune nga data e parë e publikimit të njoftimit për aplikimet për licensim në aktivitetin e prodhimit, aplikimi dhe të gjitha dokumentet shoqëruese apo çdo informacion tjetër që janë të disponueshme për inspektimin e publikut në zyrat e saj.
11. Me Vendim të Bordit të ERE-s, duke marrë parasysh pretendimet e aplikuesit, mund të vendoset që informacione ose dokumente që mund të shkaktojnë dëm tregtar ndaj aplikuesit, të mbahen konfidenciale dhe mund të ndalojë inspektimin e tyre nga ana e palëve të treta.

12. Në çdo rast ERE njofton aplikuesin për objeksionet e paraqitura ndaj aplikimit për të cilin kanë filluar procedurat e licensimit dhe kërkon sqarime nga aplikuesi për objeksionet e paraqitura nga palët e interesuara.

Neni 11

Vendimmarrja e Bordit të ERE.

1. Me plotësimin e afatit të paraqitjes së kundërshtimeve dhe ankesave, Bordi i ERE do të vlerësojë Aplikimin mbështetur në kriteret e parashikuara prej Ligjit Nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror". Në marrjen e vendimit për të miratuar apo refuzuar një Aplikim për Licensë sikurse për termat dhe kushtet e kësaj License, Bordi i ERE do të marrë në konsideratë dhe mbështesë vendimin e vet në kriteret që vijnë:
 - a. Aplikimin dhe plotësinë e saktësinë e informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur në përputhje me këtë Rregullore dhe me kërkesat për informacion shtesë në se ka pasur të tilla nga ana e ERE;
 - b. Relacionin e Drejtorise përkatëse të ERE të përgatitur në përputhje me pikën 11 të nenit 10.
 - c. Kundërshtimet dhe ankesat që kanë lidhje me çështjen, në se ka të tilla, të paraqitura nga palët e interesuara ose prej publikut të gjerë në lidhje me Aplikimin në proces vlerësimi.
 - d. Në rastin e Aplikimeve për Licensa për Transmetim dhe Shpërndarje, ekzistencën e Licensave ende të vlefshme të lëshuara më parë për të njëjtat aktivitete në vendndodhjen dhe territorin në të cilin aktiviteti i propozuar synon të kryhet.
 - e. Funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të pajisjeve, impianteve dhe/ose rrjeteve. (nuk zbatohet për rastet e furnizimit (neni 4.1.c) dhe tregtimit (neni 4.1.ç) të kësaj Rregulloreje)
 - f. Kërkesën për burime të gazit natyror.
 - g. Kërkesat për sigurinë kombëtare, jetën e banoreve, pronat, shëndetin dhe rendin publik. (nuk zbatohet për rastet e furnizimit (neni 4.1.c) dhe tregtimit (neni 4.1.ç) të kësaj Rregulloreje)
 - h. Angazhimet financiare të ndërmarra dhe garancitë e ofruara prej Aplikantit.
 - i. Mbrojtjen e mjedisit; (nuk zbatohet për rastet e furnizimit (neni 4.1.c) dhe tregtimit (neni 4.1.ç) të kësaj Rregulloreje)
 - j. Promovimin e përdorimit eficient të energjisë në sektorin e gazit natyror.
 - k. Detyrimet e shërbimit publik të pritshme prej Aplikantit sikurse përcaktuar nga legjislacioni shqiptar e në veçanti Ligji nr. 102/ 2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror".
 - l. Promovimin e një tregu konkurrues të gazit natyror dhe, të paktën në rastin e furnizimit të konsumatoreve tariforë, principin e kostos më të ulët për furnizim me gaz natyror.
 - m. Sigurinë dhe besueshmërinë e furnizimit me gaz natyror dhe aftësinë për rrjedhje në kah të kundërt të këtij furnizimi brenda Republikës së Shqipërisë.
2. Në përputhje me Rregullat e saj të organizimit dhe funksionimit, ERE do të njoftojë me shkrim të gjithë palët e interesuara për vendimin e Bordit brenda 3 ditësh pune prej marrjes së këtij vendimi.

Neni 12

Dhënia ose Refuzimi i Licensës.

1. Bordi i ERE do ta marrë vendimin përfundimtar për dhënie ose refuzimin e Licensës brenda 90 ditëve nga dita e parë e publikimit të njoftimit në media, duke e mbështetur vendimin e tij në bazë të kritereve të parashtruara në nenin 11 të kësaj Rregulloreje.

2. Vendimi përfundimtar i Bordit do të jetë me shkrim dhe do të përmbajë arsyet për dhënien ose refuzimin e Licensës.
 3. Vendimi i ERE për miratimin ose refuzimin e dhënies së një License sipas kësaj Rregulloreje do të publikohet në Fletoren Zyrtare.
 4. Vendimi i ERE mundet të apelohe në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror".
 5. Në rastet kur ERE nuk pranon të zgjasë vlefshmërinë një License zbatohen kushtet e nenit 16 të kësaj Rregulloreje.
 6. ERE mund të japë një vendim licencimi me kusht kur gjykon se ndonjë nga kushtet e paplotësuar nuk është thelbësor për ushtrimin e menjëhershëm të veprimtarisë dhe aplikuesi merr përsipër ta plotësojë atë brenda një periudhe të caktuar.
 7. Periudha e plotësimit të kushtit nuk mund të jetë më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e hyrjes në fuqi të licencës me kusht, sipas nenit 24, pika 2 të ligjit nr. 102/2015.
 8. Vendimi i ERE-s për dhënien e licencës me kusht specifikon:
 - a) kushtin e paplotësuar dhe arsyen pse konsiderohet jo thelbësor;
 - b) afatin e saktë të plotësimit të kushtit;
 - c) dokumentacionin ose provat që duhet të paraqesë i licencuari për verifikimin e plotësimit;
 - d) pasojat ligjore nëse kushti nuk plotësohet brenda afatit.
 9. I licencuari me kusht paraqet pranë ERE-s provat e plotësimit të kushtit jo më vonë se 30(tridhjetë) ditë para skadimit të afatit të përcaktuar.
 10. Nëse kushti plotësohet brenda afatit, ERE merr vendim për heqjen e kushtit dhe lëshimin e licencës përkatëse pa kusht.
 11. Nëse kushti nuk plotësohet brenda afatit të përcaktuar, ERE rishikon vendimin e licencimit me kusht dhe vendos në përputhje me kushtet dhe pasojat e përcaktuara në këtë vendim.
 12. ERE refuzon dhënien e licencës në rastet e parashikuara në nenit 26 të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar..
- Në vendimin e ERE-s për refuzimin arsyetohen shkaqet sipas pikës 1 të këtij neni.

KREU III

NDRYSHIMI DHE TRANSFERIMI I LICENSAVE

Neni 13

Procedurat e Ndryshimit të Licensave.

1. ERE mundet që me kërkesën e të Licensuarit, me iniciativën e vet ose bazuar në një vendim gjykatë të formës së prerë të ndryshojë termat dhe kushtet e një License që ajo konsideron të përshtatshme, në përputhje me procedurat e përcaktuara nga Ligji Nr 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror", mund të vendosë të ndryshojë një Licensë në rastet që vijnë:
 - a.kur ka ndryshime të disa rrethanave (siç mundet të jenë kuadri ligjor, vendime të gjykatës) që kanë ndodhur ndërmjet datës së lëshimit të Licensës dhe datës së kërkesës për ndryshim, ose
 - b.kur ka ngjarje që sjellin efekte të konsiderueshme në Sistemet e Transmetimit dhe Shpërndarjes ose në tregun e gazit natyror, ose

c.kur ka ndryshime ligjore, teknike ose financiare që e bëjnë të pamundur plotësimin e pjesshëm ose të plotë të termave dhe kushteve të parashikuara në Licensë;

3. Në se ERE vendos të ndryshojë Licensën, ajo do t'i lëshojë të Licensuarit një Licensë të amenduar me ndryshimet e bëra duke anuluar në këtë mënyrë pjesët e Licensës që nuk janë më të vlefshme. Në se i Licensuari kundërshton termat dhe kushtet e Licensës së ndryshuar atëherë do të zbatohen kushtet e nenit 16 të kësaj Rregulloreje.

4. Në rastin e një kërkesë nga i Licensuari për një ndryshim të Licensës së vet, ERE do të zbatojë të njëjtat afate dhe procedura si në rastin e licencimit sikurse përcaktohet nga kjo Rregullore. Kjo kërkesë për ndryshim do të përfshijë;

- a. Tekstin e propozuar të ndryshimit specifik që është kërkuar.
- b. Informacion me shkrim që shpjegon arsyet e kërkesës për ndryshim të Licensës.
- c. Vendimin e shoqërisë ose çdo dokument tjetër që vërteton kërkesën e të Licensuarit për ndryshimin specifik të Licensës.

5.Përpara miratimit të modifikimit të një licence, ERE publikon modifikimet e propozuara dhe shqyrton vërejtjet ose ankesat e mundshme, të paraqitura nga palët e interesuara lidhur me këtë modifikim.

Neni 15

Transferimi i Pjesshëm ose i Plotë i Licensës të Licensuarit.

1. Me kërkesën e të Licensuarit, ERE mundet të transferojë Licensën pjesërisht ose plotësisht tek një Person tjetër në përputhje me Ligjin Nr 102/2015. Në rast të transferimit të plotë ose të pjesshëm të pronësisë së aseteve, Personi tek i cili do të transferohen asetet, do të aplikojë tek ERE për një Licensë të re për aktivitetet që do të transferohen duke paraqitur dokumentacionin që vijon:

- a. Formën e Aplikimit sikurse përcaktuar në pikat 1(a), 1(b), dhe 1(c) të nenit 9,
- b. Dokumentacionin ligjor, administrativ dhe pronësor sikurse përcaktuar në pikën 1(d) të nenit 9,
- c. Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale sikurse përcaktuar në pikën 1 (e) të nenit 9,
- d. Çdo propozim për ndryshim ose zëvendësim në dokumentacionin teknik.
- e. Një deklaratë me faktet e plota që kanë të bëjnë me nevojën ose arsyet për transferimin e propozuar.
- f. Transferimi do të bëhet sipas kushteve të "Rregullores së Procedurave për Kalimin e Aseteve të të Licensuarve".

3. Me marrjen e vendimit prej ERE për fillimin e procedurave për vlerësimin e Aplikimit për transferimin e plotë ose të pjesshëm të Licensës, ERE do të publikojë Aplikimin në përputhje me pikën 5 të nenit 10 të kësaj Rregulloreje. Kushtet e pikës 6 të nenit 10 do të zbatohen për të gjitha Aplikimet për transferim License.

4. ERE do të marrë një vendim për miratimin ose refuzimin e Aplikimit për transferimin e plotë ose të pjesshëm të Licensës brenda 90 ditëve kalendarike prej ditës së fillimit të procedurave për vlerësimin e Aplikimit dhe gjatë kësaj periudhe mbajtësi aktual i Licensës do të vazhdojë të kryejë shërbimet në përputhje me detyrimet e Licensës në fuqi.

5. I propozuari për Aplikant për Licensë duhet të:

- a. ketë aftësitë dhe eksperiencën teknike dhe financiare për të marrë përsipër detyrimet që i takojnë të Licensuarit nën këtë Licensë;
 - b. pranojë dhe marrë përsipër të gjithë termat dhe kushtet e Licensës përfshirë dhënien e një Garancie Financiare dhe të një Garancie të Performancës dhe
 - c. të jetë i regjistruar dhe në përputhje me të gjithë detyrimet ligjore për të bërë biznes në Shqipëri.
6. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, çdo transferim i tillë do të jetë i kushtëzuar nga miratimi paraprak me shkrim i ERE i cili nuk do të refuzohet apo vonohet në mënyrë të paarsyeshme.
7. Njoftimi për një transferim të synuar, përshkruar në pikën 2 të këtij neni do të shoqërohet të paktën nga sa vijon:
- a. Një kopje e dokumentit ligjor të propozuar ose evidencë tjetër dokumentare e transferimit të synuar;
 - b. Dokumente që kanë lidhje me Aplikantin për Licensë të propozuar të cilat do të përfshijnë:
 - i. Bilancet financiare të audituara dhe të dhëna të tjera për të siguruar bindjen e arsyeshme të ERE-s për plotësimin e kërkesave të përcaktuara në nenin 9 të kësaj Rregulloreje;
 - ii. Të dhëna për identitetin e pronarëve të Aplikantit për Licensë të propozuar, duke patur parasysh që për rastin e një shoqërie, aksionet e së cilës janë regjistruar në një bursë të mirënjohur, këto të dhëna do të kërkojnë për pronarët kryesore (sikurse përcaktuar ose përdorur prej ligjeve ose rregullave në fuqi në bazë të të cilave këto shoqëri kanë regjistruar aksionet e tyre).
 - iii. Të dhëna për shoqëritë mëma direkte dhe indirekte, përfshirë identitetin e pronarëve të shoqërisë mëmë finale të Aplikantit për Licensë të propozuar,
 - iv. Çdo dokument ose informacion tjetër shtesë që ERE në mënyrë të arsyeshme mund ta gjejë të nevojshëm për të marrë një vendim për miratimin e transferimit të propozuar.
8. Brenda 90 ditëve kalendrike pas marrjes prej ERE të të gjithë dokumentacionit të kërkuar dhe të dhënave të tjera, ERE do të nxjerrë vendimin e vet për miratimin ose refuzimin e transferimit të propozuar. Publikimi dhe marrja e komenteve të publikut do të bëhet sipas dispozitave të nenit 10.

Neni 16

Heqja e Licensave

Me iniciativë të ERE, personave të interesuar apo mbajtësit të licensës, ERE fillon procedurën për heqjen e licensës në zbatim të parashikimeve të rregullores për procedurat e heqjes së një license.

KREU V

LËSHIMI DHE RREGJISTRIMI I LICENSAVE

Neni 17

Regjistri i Licensave

1. Mbas marrjes së vendimit nga ERE për licencimin, transferimin e pjesshëm/ të plotë ose ndryshimin e Licensës, Licensa përkatëse i lëshohet Aplikantit.
2. Një kopje e çdo Licensë të lëshuar për kryerjen e aktiviteteve në sektorin e gazit natyror mbahet nga ERE dhe regjistrohet në Regjistrin e Licensave.

3. Regjistri i Licensave do të mbahet me shkrim nga Sekretaria e Bordit, sikurse edhe në formë elektronike. Ai do të publikohet gjithashtu në faqen e internetit të ERE dhe do të rifreskohet rregullisht.

4. Regjistri i licencimeve mbahet nga struktura përgjegjëse për licencimet në ERE dhe përditësohet pas çdo vendimmarrjeje të Bordit që sjell ndryshim në të dhënat e regjistrit si dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Regjistri përmban të dhënat e mëposhtme:

- a. emrin e të licencuarit;
- b. NUIS-in dhe selinë;
- c. numrin dhe serinë e licencës;
- d. veprimtarinë e licencuar;
- e. zonën e shërbimit;
- f. numrin dhe datën e vendimit të Bordit të ERE-s për dhënien e licencës;
- g. datën e fillimit dhe datën e përfundimit të vlefshmërisë së licencës;
- h. statusin aktual të licencës;
- i. numrin dhe datën e vendimeve të Bordit të ERE-s për modifikimin, transferimin ose heqjen e licencës, sipas rastit;
- j. vendimet e licencimit të dhëna me kusht.

Neni 18

Informimi i Publikut

1. Regjistri i Licensave është i disponueshëm për publikun gjatë orarit zyrtar të punës.
2. Mbështetur në kërkesën e argumentuar të Aplikantit, ERE mund të vendosë që pjesë të informacionit përbërës të Aplikimit, dokumenteve të tij mbështetëse apo shoqëruese, ose në vetë Licensën janë me natyrë të ndjeshme komerciale dhe nuk duhet të ekspozohen. I gjithë informacioni i klasifikuar si i tillë do të trajtohet si konfidencial dhe do të jetë i mbrojtur prej ekspozimit dhe do të trajtohet vetëm sipas një vendimi të ERE-s, i marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Informacioni konfidencial nuk do të bëhet i diponueshëm për publikun nëse publikimi i tij mundet të sjellë dëme ekonomike.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 19

Amendimi i Rregullores

Kjo Rregullore mund të amendohet me vendim të Bordit të ERE.

Neni 20

Hyrja në Fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

ANEKSI A
PAGESA E REGJISTRIMIT DHE PROCEDIMIT TË NJË APLIKIMI

AKTIVITETI	Licencim	Modifikim	Rinovim	Transferim licence
Operim në impiantet e GNL-së	1 000 000	100 000 lekë	100 000	100 000 lekë
Shpërndarje të gazit natyror	1 000 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë
Furnizim të gazit natyror	1 000 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë
Funksionimin e operatorit të tregut të gazit natyror	1 000 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë
Operim në hapësirat e depozitimit të gazit natyror	1 000 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë	100 000 lekë
Tregtim të gazit natyror	40 000 lekë	30 000 lekë	30 000 lekë	30 000 lekë
<i>Operimi në impiantet e GNL-së me përmasa të vogla</i>	<i>1 000 000 lekë</i>	<i>100 000 lekë</i>	<i>100 000 lekë</i>	<i>100 000 lekë</i>
<i>Operimi në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla</i>	<i>1 000 000 lekë</i>	<i>100 000 lekë</i>	<i>100 000 lekë</i>	<i>100 000 lekë</i>

Shënim:

a) Aplikuesi, në momentin e paraqitjes së aplikimit, duhet të ketë kryer pagesën sipas përcaktimeve të këtij Aneksi. Pagesa e aplikimit është e pakthyeshme dhe mund të kryhet drejtpërdrejt në llogarinë bankare pas lëshimit të një fature elektronike nga struktura e financës në ERE, sipas kërkesës së vetë aplikuesit:

Shërbimi i komisionit të bankës (në nisje dhe mbërritje) paguhet nga aplikuesi.

b) Aplikuesi, në momentin e paraqitjes së aplikimit, bashkëlidh Deklaratën si më poshtë:

DEKLAROJ SE:

- Nuk më është hequr apo refuzuar më parë një licencë për operimin në sektorin e gazit natyror brenda apo jashtë vendit.

(Nëse aplikuesit i është hequr apo refuzuar më parë një licencë, duhet të bëjë me dije arsyet dhe vendimin përkatës)

-
-
-
-
- Jam njohur me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi dhe angazhohem për zbatimin e tij, si dhe të rregullave dhe rregulloreve të miratuara nga ERE për operimin në sektorin e gazit natyror.
 - Dokumentet dhe të dhënat e paraqitura për qëllime të këtij aplikimi janë të vërteta dhe jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.
 - Jam i gatshëm të paraqitem në ambientet e ERE-s në rast nevojë të zhvillimit të ndonjë seance dëgjimore në kuadër të këtij aplikimi.
 - Kam kryer pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të rregullores, në datën __.____._____, pranë Bankës _____.
 - Nuk jam i angazhuar në ndonjë aktivitet tjetër tregtar në Shqipëri ose vend tjetër.
(Nëse aplikuesi është angazhuar në ndonjë aktivitet tjetër tregtar, duhet të japë shpjegimet përkatëse)

Për aplikuesin

(emër mbiemër, nënshkrim)